



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Janar, 2018

Një varg takimesh me krerët e institucioneve të Kosovës

Zëvendëskryeministri Limaj i gatshëm të mbështes angazhimet e SBASHK-ut



Pas takimit në kudër të delegacionit të BSPK-së me Kryeministrin Haradinaj, e duke vazhduar me përpjekjet që çështjet e ngritura të zgjidhen me dialog, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e këshilltar për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar me Zv/kryeministrin Fatmir Limaj. Gjatë këtij takimi Zv/kryeministri Limaj i ka deklaruar delegacionit të SBASHK-ut se përcjellë vazhdimisht angazhimet dhe përkushtimin e tyre. Limaj pastaj është shprehur se do ta përkrah dërgimin sa më të shpejtë të Projektligjit (faqe 4)

Takime të ndara me Ministrat Bytyqi e Hamza

Përkrahje e kërkesave të SBASHK-ut brenda mundësive buxhetore



Pas takimit me Zv/kryeministrin Limaj i njëjti delegacion(faqe 4)

SBASHK vazhdon të forcohet në Podujevë

SHFMU "Ali Ajeti " në Sfeçël i bashkohet SBASHK-ut

Sindikata e AF dhe e AM të Podujevës në kuadrin e aktivitetit sindikal,....(faqe 6)

Intervistë me këshilltarin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Përgatitjet për Kongresin VII të SBASHK po shkojnë mirë

Ymer Ymeri është menaxher për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm. Krahas angazhimeve(faqe 3)

Drejtori i Arsimit të Prishtinës priti përfaqësuesit e SBASHK-ut

Gatishmëri e dyanshme për bashkëpunim



Me ftesën e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit të Prishtinës, z. Januz Salihu delegacioni i SBASHK-ut ... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Kanë ikur shpejt 4 vite



Erdhi shkurti i vitit 2018. Në SBASHK janë duke u bërë përgatitje për Kongresin VII. Duke parë këto angazhime e duke komunikuar me mysafirë vendor e ndërkombëtarë që do të jenë mysafirë të kësaj ngjarje të rëndësishme, njeriu kthen kujtesën në të kaluarën dhe me emocione pajtohet se shpejt kanë ikur 4 vite që kur më 22 shkurt 2014 u mbajt Kongresi VI i SBASHK. Duke shpalosur kujtimet nëpër këto katër vite ndjej krenari që isha kryetar i sindikatës më të organizuar e më të fuqishme në Kosovë. Mburrem me kolegët e mi kudo janë nëpër Kosovë që nga institucionet parashkollore, shkollat fillore e të mesme e deri në

univeristet. Bashkërisht për këto 4 vite jemi angazhuar dhe kemi arritur të realizojmë shumë kërkesa. Bashkërisht kaluam nëpër sfida dhe në momente kishim arsyeshem edhe stresa duke kërkuar përgjigje në pyetjen " çfarë tutje?!". Këto 4 vite ishin të suksesshme për SBASHK-un sepse krijuam besim të ndërsjellë dhe ruajtëm unitetin që është forca jonë më e madhe. Angazhimet, sfidat, arritjet, detyrat e kryera e ndonjë edhe të pakryer do ta shënojnë në raportin e punës dhe do ta paraqes para delegatëve më 24 shkurt, e në këtë shkrim vetëm po shpreh respekt dhe falënderim për njerëzit që punova me ta gjatë këtyre 4 viteve. Respekt edhe për veprimtarët dhe anëtarët e SBASHK-ut kudo janë nëpër Kosovë.

Ishte nder për mua të udhëheq sindikatën më të organizuar e më të përgatitur për përballje me sfidat.

Ju faleminderit.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me këshilltarin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Përgatitjet për Kongresin VII të SBASHK po shkojnë mirë



Ymer Ymeri është menaxher për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm. Krahas angazhimeve në cilësinë e menaxherit për financa e administratë ai është

shumë i angazhuar edhe në organizimin sa më të mirë të aktiviteteve të SBASHK-ut. Një përkushtim të tillë është duke e treguar edhe tani e sa kohë në përgatitjen sa më të mirë të Kongresit VII. Ai në intervistë për gazetën "Arsimimi sot" tregon lidhur me përgatitjet e bëra për Kongresin VII, që është nga ngjarjet më të rëndësishme për SBASHK sepse në të, krahas 171 delegatëve nga e tërë Kosova , pritet të marrin pjesë edhe shumë mysafirë vendorë e ndërkombëtarë.

Arsimimi sot:

Kongresi po afrohet sa jeni të kënaqur me përgatitjet e bëra deri tani?

Ymeri:

Kongresi është ngjarje e veçantë dhe do përgatitje të shumta në mënyrë që të dalim faqebardhë para mysafirëve të shumtë vendorë e ndërkombëtarë . Ne kemi nisur me kohë përgatitjet dhe puna po na shkon mbarë. Në mbledhjen e Kryesisë janë formuar disa komisione që kanë të bëjnë me përgatitjen e Kongresit dhe janë emëruar edhe përgjegjësitw e këtyre Komisioneve. Janë formuar komisionet: për pritjen dhe përcjelljen e mysafirëve ndërkombëtarw, ai për përgatitjen e materialeve të Kongresit, Komisioni për shpërndarjen e materialeve të Kongresit dhe Komisioni për përgatitjen e sallës në të cilën do të mbahet Kongresi.

Arsimimi sot:

Në Kongres do të ketë mysafirë të shumtë vendorë e ndërkombëtarë, na thoni më shumë për këtë?

Ymeri:

Po, kanë konfirmuar pjesëmarrjen Zv/kryeministri Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj dhe Ministrat Shyqiri Bytyqi , Skënder Reçica e Kujtim Shala , pastaj z. Ismajl Kurteshi, Rektori Demaj e shumë tjerë dhe nga vendet tjera Jelka Velicki nga sindikata sllovene, Clazien Rodenburg nga sindikata e arsimit të Holandës dhe përfaqësues të sindikatave nga Kroacia, Shqipëria, Bullgaria, Bosnja, Mali i Zi e vende të tjera.

Arsimimi sot:

A do të ndahet në këtë Kongres Mirënjohja Honoris Causa Fehmi Agani?

Ymeri:

Po do të vazhdojmë me këtë traditë. Me mirënjohjen me emrin e një njeriu të madh të Kosovës do të respektohen veprimtarja e madhe sindikale Trudi Kerperien, nënkryetarja në themelimet e SBASHK-ut Nediha Grapci, veprimtari Zenel Zeka dhe kryetari i dikurshëm Ali Shabanaj.

Arsimimi sot:

A do të ketë të veçanta në këtë Kongres ?

Ymeri:

Po do të priten ndryshime pozitive në Statutin e SBASHK-ut. Do të dalim edhe me rezoluta me qëllim që të ndikojmë në nxjerrjen e ligjeve që kanë të bëjnë me arsimin dhe mirëqenien e të punësuarve në arsim.

Arsimimi sot:

Çka pas Kongresit ?

Ymeri:

Do të vazhdojmë me angazhimet në shërbim të anëtarësisë .

Gjatë muajit

Një varg takimesh me krerët e institucioneve të Kosovës

Zëvendëskryeministri Limaj i gatshëm të mbështes angazhimet e SBASHK-ut

Pas takimit në kudër të delegacionit të BSPK-së me Kryeministrin Haradinaj, e duke vazhduar me përpjekjet që çështjet e ngritura të zgjidhen me dialog, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e këshilltar për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar me Zv/kryeministrin Fatmir Limaj.



Gjatë këtij takimi Zv/kryeministri Limaj i ka deklaruar delegacionit të SBASHK-ut se përcjellë vazhdimisht angazhimet dhe përkushtimin e tyre. Limaj pastaj është shprehur se do ta përkrah dërgimin sa më të shpejtë të Projektligjit për statusin e

punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës në Parlament "Mësimdhënësit e asaj kohe meritojnë respektin më të lartë pasi me mund e sakrificë kanë mbrojtur gjuhën shqipe dhe arsimin në tërësi në ato vite të vështira të Kosovës.", ka vlerësuar Limaj për të shtuar se: "Duhet ruajtur e respektuar personalitetin e mësuesit edhe sot e gjithmonë dhe atij i duhet mbështetja në përpjekjet për një arsim edhe më cilësor. Ne nuk do të veprojmë vetëm, po bashkë me SBASHK-un në të gjitha këto përpjekje", ka premtuar Limaj.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë njoftuar zv/kryeministrin Limaj për të gjitha shqetësimet duke treguar se ka tensione të ngritura te punëtorët e arsimit dhe se atyre iu drejtohem me mesazhe mobilizimi dhe respekti për misionin e tyre të shenjtë në edukimin dhe arsimimin e brezave, duke kërkuar që të japin maksimumin nga vetja e tyre për një arsim më cilësorë.

Takime të ndara me Ministrat Bytyqi e Hamza

Përkrahje e kërkesave të SBASHK-ut brenda mundësive buxhetore

Pas takimit me Zv/kryeministrin Limaj i njëjti delegacion i SBASHK-ut është takuar me Ministrin Shyqiri Bytyqi. Ata e kanë përsëritur në bisedë me




Ministrin kundërshtimin lidhur me rritjen e ulët të pagave dhe kanë shtuar edhe çështjen e Projektligjit për statusin e punëtorëve të

arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet 90-ta.

Minsitri Bytyqi është shprehur se kupton angazhimet e SBASHK-ut në përpjekje që ngritja e pagave të mos jetë 4.6 %, por një rritje më e madhe duke shtuar se as ai e as Ministria që drejton nuk është kundër ndonjë rritje tjetër të mundshme, porse kjo varët nga mundësitë buxhetore dhe se nuk është në kompetencat e tij. Minsitri Bytyqi ka përsëritur përkushtimin e tij dhe ka shprehur bindjen se Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës shumë shpejtë do të gjendet para deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës.

Ministri Bytyqi e ka ritheksuar edhe një herë se MASHT nuk angazhohet për as një lloj testimi me shkrim për njohuritë e mësimdhënësve, por është duke u angazhuar të gjendet një formë për vlerësimin e performancës në punë dhe për të gjetur forma që të dihet se për cilat trajnime kanë nevojë mësimdhënësit sipas shkollave e pastaj edhe komunave.



Drejtori i Arsimit të Prishtinës priti përfaqësuesit e SBASHK-ut

Gatishmëri e dyanshme për bashkëpunim

Me ftesën e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit të Prishtinës, z. Januz Salihu delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga nënkryetari i parë Lutfi Mani dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë vizituar këtë drejtori ka informuar z. Salihun për angazhimet që kjo sindikatë bënë në shërbim të anëtarësisë dhe për përpjekjet që të realizoj kërkesat nga Kontrata Kolektive.



Ata i kanë dhënë theks të veçantë përkushtimit lidhur me projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit të Republikës së Kosovës për vitet '90 duke kërkuar edhe mbështetjen e tij që ky ligj sa më parë të jetësohet. Në

Në përpjekje për të gjetur mbështetje për realizimin kërkesave të anëtarësisë delegacioni i SBASHK-ut është takuar fillimisht edhe zv/ministrin e Financave, z. Fatmir Gashi e pastaj edhe me Ministrin në këtë Ministri, z. Bedri Hamza. Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e këshilltar për organizim të brendshëm Ymer Ymeri në këto dy takime kanë shprehur kundërshtimin lidhur me rritjen e ulët të pagave prej 4 % duke kërkuar mbështetjen që kjo rritje të jetë me e lartë. Gashi e Hamza janë shprehur se kuptojnë këtë shqetësim të SBASHK-ut, por kanë deklaruar se për rritje më të lartë nuk ka mjete buxhetore. Dhe se mbase eventualisht me rishikimin e buxhetit mund të bëhet ndonjë lëvizje tjetër.

kuadër të bashkëbisedës delegacioni i SBASHK-ut i kanë bërë apel z. Salihut që Prishtina të realizojë Kontratën Kolektive e veçmas çështjen e pagave jubilarë dhe tre pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, pa pasur nevojë që kjo çështje të zgjidhet përmes Gjykatës.

Drejtori i DKA-së së Prishtinës, z. Salihu ka shprehur respekt për punën e SBASHK-ut duke u shprehur se është për një bashkëpunim korrekt e të vazhdueshëm me SBASHK-un. Ai ka shtuar se do të mundohet që t'i mbështes kërkesat e SBASHK-ut duke gjetur mundësi për realizimin e tyre sa u takon mësimdhënësve të kryeqytetit.

Po ashtu z. Salihu i ka premtuar SBASHK-ut se do të jap kontribut brenda kompetencave të tij për ta jetësuar sa më parë ligjin për statusin e mësimdhënësve të viteve '90. Të dy palët janë pajtuar që të vazhdohet me bashkëpunimin dhe me takimet në mënyrë që bashkërisht të angazhohen e të punojnë në shërbim të arsimit.

SBASHK vazhdon të forcohet në Podujevë

SHFMU "Ali Ajeti" në Sfeçël i bashkohet SBASHK-ut

Sindikata e AF dhe e AM të Podujevës në kuadrin e aktivitetit sindikal, sot ka zgjedhur kryesinë dhe kryetarin e Shoqatës Sindikale të SHFMU "Ali Ajeti" në Sfeçël ". Në këtë mbledhje ku ishte i pranishëm edhe kryetari i SAF e SAM të Podujevës, Fadil



Halimi, mësimdhënësit e kësaj shkolle kanë zgjedhur Kryesinë prej 5 anëtarëve me kryetar arsimtarin Burim Bajgorën dhe nënkryetare, mësuesen Shukrije Bajramin.

Në hapje të takimit, kryetari i SAF e SAM të Podujevës, ka përshëndetur anëtarët e rinj të SBASHK-ut, pastaj ka bërë një pasqyrim të angazhimeve, arritjeve dhe sidave të sindikalistëve të arsimit në këtë komunë. Ai po ashtu në kuadër të bashkëbisedimit me anëtarët e Shoqatës sindikale të shkollës "Ali Ajeti" u është përgjigjur shumë pyetjeve për çështje të caktuara sindikale.

SBASHK-ut, kohë më parë i janë bashkangjitur edhe Shkollat fillore të Mesme të ulëta të qytetit "Shaban Shala", "Enver Maloku" dhe "Ibrahim Rugova".

SBASHK-u marrëveshje "Olive Medicinal Group" dhe me "DUA tour"

Respekt për punëtorët arsimor të Kosovës

Në angazhimet e vazhdueshme që të jetë në shërbim të anëtarësisë SBASHK-u ka nënshkruar edhe dy marrëveshje për zbritje çmimesh të shërbimeve. Njëra nga marrëveshjet ka të bëjë me Poliklinikën "Olive Medicinal Group", e cila ndodhet në Lagjen "Kalabria" të Prishtinës.

Marrëveshja tjetër është lidhur me Operatorin turistik "DUA TOUR" me seli në Rr. Jeronim De Rada, Prizren dhe në Prishtinë.



Përgjegjësit "Olive Medicinal Group" me rastin e solemnitetit të nënshkrimit të marrëveshjes kanë

thënë se këtë po e bëjnë në shenjë respekti për punën dhe përkushtimin e punëtorëve të arsimit në edukimin dhe arsimimin e brezave. Marrëveshja saktëson se ajo mundëson pranimin e pacientëve, marrja e mostrave

dhe testimi, dhënia e rezultateve dhe nëse ka nevojë edhe konsultimi me mjekun.

Në marrëveshje është saktësuar se shërbimet e laboratorit për anëtarët e ngushtë të familjeve do të jenë me zbritje prej 20 % nga çmimi në kohën e kryerjes së këtij shërbimi, kurse për vetë anëtarët e SBASHK-ut kjo zbritje do të jetë 25 %.

Marrëveshja me Operatorin turistik "DUA TOUR" specifikon se të gjithë anëtarët e SBASHK-ut, që posedojnë kartelën e kësaj sindikate dhe anëtarët e familjes së ngushtë gëzojnë zbritje të çmimeve të



shërbimeve. Po ashtu dhe të afërmit e tyre, si prindërit, baxhanakët, kunetët mund të shfrytëzojnë të njëjtat zbritje, por me kusht që në këtë udhëtim turistik të jetë me ta së paku një anëtar i SBASHK-ut. Detajet

e zbritjes së çmimeve janë saktësuar në marrëveshje, ndërsa në ofertat nga “Dua Tour” i gjeni në : <https://www.facebook.com/DUATOURLIST/>

Reagim i SBASHK-ut ndaj deklaratave të Kryeministrit Haradinaj për arsimin dhe mësuesit

Kryeministër mësuesit kanë pritur mesazhe mobilizimi nga ju e jo ofendime



Kryeministër nuk është mirë të lëndohet personaliteti i mësuesit sepse këta njerëz me përkushtim punuan dhe ishin kthyer në digë për mbrojtjen e arsimit shqip nga sulmet e pushuesit serb në vitet më të vështira të Kosovës . Kryeministër shkollat në Kosovë nga jashtë janë mjaft të bukura, por nga brenda janë tepër të thata sepse në to mungojmë mjetet elementare të punës. Mësuesi ynë ende punon vetëm me shkumës , shpuzë e tabele dhe në këto kushte arritjet në arsimin tonë janë të mira.

I nderuari Kryeministër punëtorët e arsimit në Kosovë kishin pritur me entuziazëm ardhjen tuaj në krye të Qeverisë me shpresën se ju do të dërgoni te ta mesazhe mobilizimi në shërbim të një arsimit edhe më të mirë. Ata kanë pritur që ju do të uleni vazhdimisht dhe do të bashkëbisedoni me SBASHK-un, që është sindikata e tyre, dhe do të gjeni rrugëdalje për të gjitha shqetësimet.

Në vend të kësaj Ju kryeministër në disa paraqitje publike lënduat figurën e mësuesit dhe zhvleftësuar punën e tyre nëpër dekada e vite duke deklaruar , pa bërë analiza nga ekspertët , se gjendja në arsim është shumë e keqe e duke shkuar më tutje se gjoja ata vetëm luajnë shah apo i bëjnë nxënësit e dy a tri ndërrimeve bashkë sa për të thënë se po punojnë, apo edhe se këtë mësuesit nuk kanë qenë nxënës e as studentë të mirë . Kryeministër nuk është mirë të lëndohet personaliteti i mësuesit sepse këta njerëz me përkushtim punuan dhe ishin kthyer në digë për mbrojtjen e arsimit shqip nga sulmet e pushuesit serb në vitet më të vështira të Kosovës . Si ilustrim po kujtojmë vrasjen nga pushtuesi serb të mësuesit Halit Geci. Pas varrimit të tij mësuesit nuk ikën nga fshati po të nesërmen vazhduan mësimin duke mbajtur gjallë

shpresat për liri e ardhmëri të Kosovës. Apo po kujtojmë vdekjen nga torturat e pushtuesit të drejtorit Haki Povataj dhe vazhdimin e punës në shkollën e tij dhe në të gjitha shkollat kudo në Kosovë.

I nderuari Kryeministër nuk është mirë që të deklaroheni se nuk mërztieni për paralajmërimet për greva nga SBASHK-u. Në vend të kësaj është më mirë të bisedohet me ta dhe me sindikatat tjera sepse kundër rritjes 4 % janë mësimdhënësit, po se po, por edhe gjithë të punësuarit në sektorin publik dhe kjo është artikuluar përmes sindikatave të tyre në BSPK. I nderuari Kryeministër ua kemi thënë edhe të tjerëve e po ua themi publikisht edhe Juve se asgjë në arsimin e Kosovës nuk mund të bëhet pa pajtueshmërinë e punëtorëve të arsimit dhe sindikatës së tyre. Ju mund t'i injoroni kërkesat e Mësimdhënësve të artikuluar përmes SBASHK-ut , por në këtë mënyrë po i dërgoni ata drejt grevave. SBASHK-u është unik dhe di të bëjë greva i nderuari Kryeministër , por atyre u ka ikur shpesh duke i dhënë përparësi zgjidhjes së çështjeve të ngritura përmes dialogut.

Kryeministër shkollat në Kosovë nga jashtë janë mjaft të bukura, por nga brenda janë tepër të thata sepse në to mungojmë mjetet elementare të punës. Mësuesi ynë ende punon vetëm me shkumës , shpuzë e tabele dhe në këto kushte arritjet në arsimin tonë janë të mira . Shteti duhet të financojë në arsim dhe të krijojë shkolla të shekullit 21 dhe të shtojë mobilizimin për punë përmes bashkëbisedave me respekt e këshilla mobilizuese e jo me diktate e vlerësime ofenduese ndaj mësuesit dhe profesionit të tij të shenjtë. Kryeministër nga tani e tutje nga ju , në vend të deklaratave që lëndojnë, presim mesazhe respekti dhe mobilizimi në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsimin e Kosovës.

